FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTICS FEDERATION

Raporti i garës së NIVELIT C

Data: 28 Qershor 2025
Vendi: Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, Prishtinë
Organizator: Federata e Gjimnastikës së Kosovës
Mbështetës: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, GiFi Kosova dhe Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit

-Përshkrimi.
Më 28 qershor 2025, Federata e Gjimnastikës së Kosovës organizoi garat e Nivelit B në gjimnastikën artistike Gara e nivelit B është niveli i dytë më i lartë në Kosovë dhe është i përshtatur për gjimnastet e mira me më shumë eksperience sesa niveli C.
Lajmërimi zyrtar për garën e Nivelit B iu dërgua klubeve më datë 30 maj 2025, së bashku me manualin teknik dhe udhëzimet e plota për garë. Kjo u bë me qëllim që të gjithë klubet të kenë kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur.

Te paraqitura në garë ishin 90 gjimnast-e nga 12 klube pjesëmarrëse prej të cilave 2 klube ishin nga Shqipëria dhe 10 klube nga Kosova.

Klubet pjesëmarrëse nga Kosova:
1. Akademia e Gjimnastikës Ardhmëria,
2. Klubi i Gjimnastikës Elita,
3. Klubi i Gjimnastikës Fushë Kosova,
4. Klubi i Gjimnastikës Halil Alidema Gjilan,
5. Klubi i Gjimnastikës Halil Alidema Viti,
6. Klubi i Gjimnastikës Kulina,
7. Klubi i Gjimnastikës Llapi,
8. Klubi i Gjimnastikës Omnisport,
9. Klubi i Gjimnastikës Skenderaj,
10. Klubi i Gjimnastikës Vushtrria

Klubet nga Shqipëria:
1. Klubi i Gjimnastikës Tomorri Olimpik
2. Klubi i Gjimnastikës Xheni Gjimnastikë

Gara u zhvillua në tri disiplina: parter, tra dhe kapërcime.
Medaljet u ndanë për çdo vit të lindjes veç e veç.

Gjyqtaria u nda në tre panele dhe kishte këtë përbërje:
Parter: Abeliana Bregu, Drinesa Qerimi, Arlind Shaqiri
Tra: Doruntinë Ibrahimi, Qendresa Halili, Vilëza Zeqiri, Xhevrije Fetahu
Kapërcime: Ard Kryeziu, Lisa Zeqiri, Elena Manxholli

Ecuria e garës.
09:15 – Takimi i trajnerëve dhe organizatorëve
10:00 – Fillimi i garës
15:00 – Përfundimi i garës
15:30 – Ceremonia e medaljeve dhe shpërblimeve

Salla ishte e përgatitur një ditë para garës.
Gara u hap zyrtarisht me intonimin e himnit të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Shqipërisë, si shenjë respekti për pjesëmarrjen nga të dy vendet.
Një fjali hyrëse u mbajt nga Kryetari i Federatës së Gjimnastikës së Kosovës, z. Shkumbin Maqastena.
Gara filloj në ora 10:00 me nxemjet e gjimnasteve në vegla. Gjimnastet u ndanë në katër grupe, dhe kishte 4 rotacioneve ku njëra prej tyre ishte pushim.
Zërimi ka funksionuar mirë gjatë tërë garës, dhe publiku ka qenë prezent në numër të madh.
Rotacionet janë zhvilluar në një rrjedhë kryesisht të mirë, ku çdo grup i gjimnastëve ka pasur kohë të mjaftueshme për nxemje para çdo disipline, por ka pasur gjysmë ore vonesë në fillim të garës për shkak që klubet nuk i kan sjellur muzikat e garuesëve me kohë.
Mjeku ishte prezent gjatë tërë ditës, por fatmirësisht asnjë lëndim nga gjimnastet tona në këtë garë. Punëtorët e angazhuar nga FGJK ishin prezent gjatë tërë ditës në garë dhe ndihmuan me lëvizjen e paisjeve, mbajtjen e rendit, orientimin e publikut etj. Poashtu FGJK angazhoj edhe një fotograf që të kapen momentet në foto të bukura.
Medalje kishte për gjimnastet në vendin e parë, të dytë dhe të tretë për cdo vegël në secilin vit të lindjes. Nëse pikët ishin shumë të barabarta, gjyqtarët vendosnin më shumë se një gjimnaste në të njejten renditje duke e ndarë ato poziten e njejtë.
Gjimnastet e Shqipërisë u vlerësuan në garë me të njejtat kritere si gjimnastet nga Kosova. Në rastet kur një gjimnaste nga Shqipëria renditej në top 3, ajo nuk e zëvendësonte një gjimnaste nga Kosova në renditje, por e ndante vendin dhe medaljen me gjimnasten kosovare që renditej në atë pozitë.
Gifi Kosova kishte përgatitur dhurata të bukura për të gjitha gjimnastet pjesëmarrëse.

Përfundim

Gara e Nivelit B, e organizuar nga FGJK më 28 qershor 2025, u realizua me sukses, me pjesëmarrje të madhe gjimnastesh dhe me vlerësim të drejtë.
Gara u zhvillua në mënyrë të rregullt dhe u realizua me një pjesëmarrje të lartë të publikut dhe me atmosfere të mirë. Në të ardhmen për të garantuar rrjedhshmëri edhe më të mirë, muzikat e do të pranohen vetëm nëse dorëzohen brenda afatit të përcaktuar.

Disa foto nga gara:

